



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

---

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK  
MINISTARSTVO EKONOMSKOG RAZVOJA  
MINISTRY OF ECONOMIC DEVELOPMENT

**Raporti i  
Progresit**

**Për Vitin 2012**

**Programi për Zbatimin e Strategjisë Minerare  
2012-2014**

Shkurt, 2013

## PËRMBAJTJA

---

|  |    |
|--|----|
| SHKURTESAT .....   | 3  |
| HYRJE .....  | 4  |
| METODOLOGJIA PËR PËRGATITJEN E RAPORTIT TË PROGRESIT ..... | 5  |
| SHTYLLA E PARË .....                                       | 6  |
| SHTYLLA E DYTË .....                                       | 14 |
| SHTYLLA E TRETË .....                                      | 17 |
| SHTYLLA E KATËRT .....                                     | 18 |
| PROJEKTET RELEVANTE .....                                  | 21 |
| INDIKATORËT E PËRFORMANCËS .....                           | 22 |



## SHKURTESAT

---

|         |  |
|---------|--|
| MZHE    | Ministria e Zhvillimit Ekonomik  |
| DPZHEIE | Departamenti i Politikave të Zhvillimit Ekonomik dhe Integritimeve Evropiane                       |
| DEM     | Departamenti i Energjisë dhe Minierave   |
| IGJK    | Instituti Gjeologjikë i Kosovës  |
| AKP     | Agjencia Kosovare e Privatizimit   |
| INKOS   | Instituti, Inkos sh.a.   |
| MMPH    | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  |
| KEK     | Korporata Energjetike e Kosovës  |
| KPMM    | Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale   |
| TC      | Termocentrali  |
| SM      | Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, 2012-2025   |
| PZSM    | Programin për Zbatimin e Strategjisë Minerare, 2012-2014   |
| SJP     | Sibovci Jug-Perëndim   |
| BK      | Buxheti i Kosovës  |
| EITI    | Extractive Industries Transparency Initiative (Iniciativa e Transparencës së Industrive Nxjerrëse) |
| DGJ     | Divizioni i Gjenerimit   |



## HYRJE

---

Raporti i progresit për vitin 2012 përshkruan progresin e realizimit të projekteve, gjegjësisht aktiviteteve, të parapara në PZSM 2012-2014.

Raporti, gjithashtu, mëton të identifikoj projekte dhe aktivitete të tjera të realizuara brenda sektorit minerar të cilat nuk kanë qenë pjesë e planifikimit në PZSM 2012-2014.

Ky raport identifikon progresin e realizuar dhe identifikon sfidat për mos realizimin e projekteve/aktiviteteve të caktuara.

Identifikimi i sfidave do të ndihmojë në lehtësimin e punës në adresimin e çështjeve të cilat mund të konsiderohen si pengesë për zhvillimin e mëtutjeshëm të sektorit, dhe kjo do të ndihmojë drejtë përmirësimit të planifikimit, realizimit dhe analizimit më të thukët sa i përket planifikimit të kostos dhe kohës së realizimit të projekteve.

Rrjedhimisht, raporti vjetor i progresit do të shërbejë edhe si bazë për rishikimin e politikave zhvillimore minerare që do të mund të reflektoheshin në rishikimin e Strategjisë Minerare.



## METODOLOGJIA PËR PËRGATITJEN E RAPORTIT TË PROGRESIT

---

Raporti i Progresit për vitin 2012 lidhur me Programin për Zbatimin e Strategjisë Minerare 2012-2014 (RP për 2012, për PZSM 2012-2014), është përgatitur në përputhje me Ligjin për Miniera dhe Minerale nr. 03/L-163, Strategjinë Minerare të Republikës së Kosovës 2012-2025 si dhe PZSM 2012-2014.

MZHE-DPZHEIE ka koordinuar procesin e hartimit të raportit të progresit; ndërsa, në hartimin e këtij dokumenti kanë marrë pjesë institucionet relevante të sektorit mineral siç janë: MZHE-DEM, MZHE-IGJK, KEK, Trepça - AKP, KPMM, MMPH dhe INKOS sh.a..

Fillimisht, DPZHEIE ka hartuar modelin e raportimit përmes tabelave/fishave, ku janë paraqitur projektet e parapara në PZSM për vitin 2012. Gjithashtu, takimet e punës me institucionet e cekura janë kryesuar nga DPZHEIE. Në takimin e parë (i) është bërë diskutimi i formës dhe mënyrës së raportimit, kurse në takimin e dytë (ii) është diskutuar progresi i secilit projekt për vitin 2012 të paraqitur në PZSM 2012-2014. Përveç takimeve, DPZHEIE sipas nevojës ka kontaktuar institucionet relevante dhe ka diskutuar lidhur me çështjet e caktuara.

Më poshtë janë të paraqitura tabelat me emërtimet e projekteve/aktiviteteve sipas PZSM 2012-2014, të pasuara me kolonën e realizueshmërisë (përqindja e realizimit) dhe kolonën e komenteve.



## SHTYLLA E PARË

| <b>Krijimi i Kushteve të Favorshme për Valorizimin Ekonomik të Resurseve Minerale dhe Tërheqjen e Investimeve</b> |  |   |                                     |   |  |   |
|---|--|---|-------------------------------------|---|--|---|
| Nr.   | Projekti/Aktiviteti i paraparë në vitin 2012         | Treguesi (SM)                                   | Institucioni përgjegjës             | Kostoja në € për vitin 2012 dhe Burimi i Financimit | Rezultatet e arritura  | Komentet  |
| <b>Objektivi 1. Plotësimi i Infrastrukturës Ligjore dhe Rregullatore</b>  |  |   |                                     |   |  |   |
| <b>1</b>  | Rishikimi ligjit 03/L-163 Për Minierat dhe Mineralet | Sht. I<br>Objektivi 1. Hartimi i Ligjit mineral | Kuvendi i Kosovës, Qeveria dhe MZHE | Nuk ka kosto.                                       | Është miratuar në parim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.<br><div style="border: 1px solid black; padding: 2px; display: inline-block; background-color: #d9ead3;">Realizimi: 75%</div> | Pritet miratimi përfundimtar nga Kuvendin e Republikës së Kosovës |
| <b>Objektivi 2. Hartimi i politikave zhvillimore për sektorin mineral</b>   |  |   |                                     |   |  |   |
| <b>1</b>  | Anëtarësimi Kosovës në EITI                          | Sht. I,<br>Objektivi 2,<br>Masa I.2.5           | MZHE                                | 5,000 BK  | Është bërë analizimi i kriterëve dhe rregullave, që duhet të përmbushen përgjatë procesit të   | Kostoja e paraparë për këtë aktivitet brenda vitit 2012 nuk       |

|   |   |                                  |   |              |   |                    |
|---|---|----------------------------------|---|--------------|---|--------------------|
|   |   |                                  |   |              | anëtarësimi.<br>Realizimi: 15%  | është shfrytëzuar. |
| 2 | Hapja e vend-punishteve të reja në Horizontet X dhe XI në minierën e Stan Tërg-ut                                       | Sht. I, Objektivi 2, Masa I.2.3  | Trepça                                  | 930,000 BK   | Janë hapur vend punishtet e reja të parapara me projekt.<br>Realizimi: 100%   |                    |
| 3 | Riaftësimi i vend-punishteve në Horizontin VIII dhe IX në minierën e Stan Tërg-ut                                       | Sht. I, Objektivi 2, Masa I.2.3  | Trepça                                  | 1,000,000 BK | Është bërë furnizimi me makinë eksploatuese dhe materiale tjera për riaftësimin e vend punishteve siç është paraparë me projekt<br>Realizimi: 100%  |                    |
| 4 | Projekti plotësues i xehetarisë për shfrytëzimin sipërfaqësor të xeheve së nikelit në minierën Gllavicë Magure – Lipjan | Sht. I, Objektivi 2, Masa I.2.3. | Newco Ferronikeli Complex L.L.C.<br>KPM | Nuk ka kosto | <ul style="list-style-type: none"> <li>Përcaktimi i metodave dhe mënyrës së shfrytëzimit;</li> <li>Dokumentimi i mënyrës së shfrytëzimit;</li> <li>Rendi dhe siguria më e lartë gjatë shfrytëzimit të minierës;</li> <li>Është përgatitur plani i punimeve minerare për dy vitet, 2012-2013.<br/>Realizimi: 100%</li> </ul> |                    |
| 5 | Projekti plotësues i xehetarisë për shfrytëzimin sipërfaqësor të xeheve së nikelit në minierën                          | Sht. I, Objektivi 2, Masa I.2.3. | Newco Ferronikeli Complex L.L.C.<br>KPM | Nuk ka kosto | <ul style="list-style-type: none"> <li>Përcaktimi i metodave dhe mënyrës së shfrytëzimit;</li> <li>Dokumentimi i mënyrës së shfrytëzimit;</li> </ul>  |                    |

|   |  |                                 |                  |              |   |                              |
|---|--|---------------------------------|------------------|--------------|---|------------------------------|
|   | Çikatovë- Drenas   |                                 |                  |              | <ul style="list-style-type: none"> <li>Rendi dhe siguria më e lartë gjatë shfrytëzimit të minierës;</li> <li>Është përgatitur plani i punimeve minerare për vitin, 2012 -2013.</li> </ul> <p>Realizimi: 100%</p>  |                              |
| 6 | Projekti i shfrytëzimit të Targetit të Kromit Briu i Gjeletocit (karriera), Llapçevë (k.k Rahovec) | Sht. I, Objektiv 2, Masa I.2.3. | Arsish.p.k. KPMM | Nuk ka kosto | <ul style="list-style-type: none"> <li>Përcaktimi i metodave dhe mënyrës së shfrytëzimit;</li> <li>Dokumentimi i mënyrës së shfrytëzimit;</li> <li>Rendi dhe siguria më e lartë gjatë shfrytëzimit të minierës;</li> <li>Është përgatitur plani i punimeve minerare për vitin 2012 -2013.</li> </ul> <p>Realizimi: 100%</p> |                              |
| 7 | Plani plotësues afatmesëm për vitin 2013-2017 për Minierën SPJ                                     | Sht. I, Objektiv 2, Masa I.2.3. | INKOS sh.a.      | 44,500 KEK   | Është punuar plani afatmesëm për furnizim me qymyr për periudhën 2013-2017 me kërkesë të KEK-ut   |                              |
| 8 | Projektimi i palosjes së deponis së hirit nga TC Kosova B  | Sht. I, Objektiv 2.             | INKOS sh.a.      | 11,600 KEK   | Projekti nuk është realizuar. Pritet që në vitin 2013 të realizohet ky projekt  | Mungesa e Mjeteve Financiare |
| 9 | Hulumtimet Gjeologo-Mekanike në minierën SJP   | Sht. I, Objektiv 2.             | INKOS sh.a.      | 33,000 KEK   | Është bërë identifikimi i shpateve me pjerrtësi të lartë që do të mundësojnë eliminimin e rreziqeve gjatë   |                              |



|  |  |                     |     |               |   |                              |
|--|--|---------------------|-----|---------------|---|------------------------------|
|  |  |                     |     |               | kohës së ekspluatimit të qymyrit.<br>Realizimi: 100%  |                              |
| 10*  | Riparimi i Sistemi i shiritave transportues të linjtit B-1600 mm (3 km) (vazhdimësi e projektit nga 2011) si dhe riparimi i shiritave të djerrinës | Sht. I, Objektiv 2. | KEK | 3,990,000 KEK | Rritja e efikasitetit dhe sigurisë në furnizim me qymyr. Projekti ka përfunduar.<br>Realizimi: 100% | Kostoja totale: 52,940,000€  |
| 11*  | Riparimi i ekskavatorit: (E 5M) dhe (E 7M), (E10M,Djerrinë) si dhe shiritave vetëlëvizës (vazhdimësi e projektit nga 2011)                         | Sht. I, Objektiv 2. | KEK | 360,000 KEK   | Kompletimi i projektit SJP si dhe rritja e kapaciteteve prodhuese<br>Realizimi: 100%                | Kostoja totale: 22,180,000€  |
| 12*  | Riparimi i palosësit (P4M) - Djerrinë  | Sht. I, Objektiv 2. | KEK | 600,000 KEK   | Kompletimi i projektit SJP si dhe rritja e kapaciteteve prodhuese<br>Realizimi: 100%                | Kostoja totale: 11,360,000 € |
| 13*  | Blerja dhe montimi i Stacionit Teleskopikë. (Stacionet shkarkuese në dy ose më shumë shirita përgjatë procesit të prodhimit të qymyrit)            | Sht. I, Objektiv 2. | KEK | 4,160,000 KEK | Kompletimi i projektit SJP si dhe rritja e kapaciteteve prodhuese<br>Realizimi: 100%                | Kostoja totale: 4,930,000 €  |
| *Projektet të cilat nuk janë përfshirë në PZSM (2012-2014). Këto projektet kanë filluar përgjatë vitit 2010-2011, dhe kanë përfunduar brenda vitit 2012.<br>Këto projekte janë paraqitur nga KEK-DPQ dhe janë në harmoni me masat dhe politikat zhvillimore të parapara me SM, përkatësisht Shtyllën e parë objektivin 2 të SM-së. |  |                     |     |               |   |                              |
| <b>Objektivi 3.Zhvillimi i politikave fiskale</b>  |  |                     |     |               |   |                              |
|  |  |                     |     |               |   | Në periudhën                 |

|   |   |                                  |      |              |   |  |
|---|---|----------------------------------|------|--------------|---|--|
|   |   |                                  |      |              |   | kohore 2012 – 2014 nuk është planifikuar ndonjë aktivitet lidhur me këtë objektivë                                     |
| <b>Objektivi 4.. Realizimi i rivlerësimit ekonomik të potencialit mineral</b> |   |                                  |      |              |   |  |
| 1   | Studimi i Fizibilitetit për Pellgun Qymyrbajtës të Dukagjinit | Sht. I, Objektivi 4, Masa I.4.3  | MZHE | 82,500 BK    | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Është përcaktuar fusha e shtrirjes së qymyrit;</li> <li>• Janë identifikuar fushat dhe modeli i shfrytëzimit të qymyrit;</li> <li>• Është përzgjedhë fusha për hapjen e mihjes së re për shfrytëzim të qymyrit, e cila ka kushte të volitshme gjeolog - minerare dhe kushte të mira të infrastrukturës ;</li> </ul> <p style="text-align: center;">Realizimi: 100%</p> | Projekti ka pasur kosto shtesë nga ai planifikuar, prej: 5,575 € - (6.76%)<br>Kostoja përfundimtare: 88,075 € , nga BK |
| 2   | Studimi i fizibilitetit për pellgun qymyrbajtës të Drenicës   | Sht. I, Objektivi 4, Masa I.4.3. | MZHE | 49,500.58 BK | Studimi ka përmbledh, analizuar dhe ka paraqit të dhënat dhe informacionet e kushteve gjeologo-minerare për fushat e shtrirjes së qymyrit, janë identifikuar rezervat gjeologjike, është përzgjedhë fusha për hapjen e mihjes së re për shfrytëzim.   | Realizimi: 100%  |

|   |   |                     |                                       |              |   |   |
|---|---|---------------------|---------------------------------------|--------------|---|---|
| 3 | Elaborati gjeologjik mbi rezervat dhe kualitetin e mergelëve në lokalitetin Dimcë-Hani i Elezit | Sht. I, Objektiv 4. | Sharrcem sh.p.k. KPMM                 | Nuk ka kosto | <ul style="list-style-type: none"> <li>Përcaktimi i rezervave të shfrytëzueshme të vendburimit;</li> <li>Dokumentimi i rezervave të vendburimit.</li> </ul> <p>Realizimi: 100%</p>                  | Raportime mbi gjendjen e rezervave pas çdo viti kalendarik, në KPMM   |
| 4 | Projekti kryesor i shfrytëzimit të mergelës nga vendburimi Dimcë-Hani i Elezit                  | Sht. I, Objektiv 4. | Sharrcem sh.p.k. KPMM                 | Nuk ka kosto | <ul style="list-style-type: none"> <li>Dokumentimi i mënyrës së shfrytëzimit;</li> <li>Rritja e nivelit të sigurisë gjatë shfrytëzimit të minierës.</li> </ul> <p>Realizimi: 100%</p>               | Raportime mbi dinamikën e shfrytëzimit në korrelacion me planifikimin e prodhimit vjetor sipas projektit të shfrytëzimit të pranuar |
| 5 | Elaborati gjeologjik për llogaritjen e rezervave të Nikelit në vendburimin Gllavicë – Lipjan    | Sht. I, Objektiv 4. | Newco Ferronikeli Complex L.L.C. KPMM | Nuk ka kosto | <ul style="list-style-type: none"> <li>Përcaktimi i rezervave të shfrytëzueshme të vendburimit;</li> <li>Dokumentimi dhe kategorizimi i rezervave të vendburimit.</li> </ul> <p>Realizimi: 100%</p> | Raportime mbi gjendjen e rezervave pas çdo viti kalendarik  |
| 6 | Elaborati gjeologjik për llogaritjen e rezervave të Nikelit në vendburimin Çikatovë- Drenas     | Sht. I, Objektiv 4. | Newco Ferronikeli Complex L.L.C. KPMM | Nuk ka kosto | <ul style="list-style-type: none"> <li>Përcaktimi i rezervave të shfrytëzueshme të vendburimit;</li> <li>Dokumentimi dhe kategorizimi i rezervave të vendburimit.</li> </ul> <p>Realizimi: 100%</p> | Raportime mbi gjendjen e rezervave pas çdo viti kalendarik  |

|   |   |                        |                     |              |   |  |
|---|---|------------------------|---------------------|--------------|---|--|
| 7 | Raport gjeologjik me llogaritje të rezervave të Kromit të targetit Briu i Gjelocit (Karriera), k.k Rahovecit.             | Sht. I, Objektiv 4.    | "Arsi" sh.p.k. KPMM | Nuk ka kosto | <ul style="list-style-type: none"> <li>Përcaktimi i rezervave të shfrytëzueshme të vendburimit;</li> <li>Dokumentimi dhe kategorizimi i rezervave të vendburimit.</li> </ul> <p>Realizimi: 100%</p>   | Raportime mbi gjendjen e rezervave pas çdo viti kalendarik |
| 8 | Vendburimet dhe shfaqjet e mineralizimeve të Pb-Zn-Cu për tërë territorin e Kosovës                                       | Sht. I, Objektiv 4.    | MZHE                | Nuk ka kosto | <p>Është krijuar baza e të dhënave për Vendburimet dhe shfaqjet e mineralizimeve të Pb-Zn-Cu për tërë territorin e Kosovës që përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Vend ndodhjen;</li> <li>Përshkrimin e gjeologjisë për paraqitjet në fjalë.</li> <li>Nivelin e hulumtimeve;</li> <li>Rezervat;</li> <li>Analizat laboratorike;</li> <li>Shpimet etj.</li> </ul> <p>Realizimi: 100%</p> | Projekti është realizuar nga stafi i IGJK-së               |
| 9 | Vendburimet dhe shfaqjet e mineralizimeve të mineraleve industriale (Bentonitet dhe Kuarci) për tërë territorin e Kosovës | Shtylla I, Objektiv 4. | MZHE                | Nuk ka kosto | <p>Është krijuar baza e të dhënave për Vendburimet dhe shfaqjet e mineralizimeve të mineraleve industriale (Bentonitet dhe Kuarci) për tërë territorin e Kosovës që përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Vend ndodhjen;</li> </ul>   | Projekti është realizuar nga stafi i IGJK-së               |

|  |  |  |  |  |  |  |
|--|--|--|--|--|--|--|
|  |  |  |  |  | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkrimin e gjeologjisë për paraqitjet në fjalë.</li> <li>- Nivelin e hulumtimeve;</li> <li>- Rezervat;</li> <li>- Analizat laboratorike;</li> </ul> <p>Shpimet etj.</p> <p style="text-align: right; border: 1px solid black; padding: 2px;">Realizimi: 100%</p> |  |
|--|--|--|--|--|--|--|

## SHTYLLA E DYTË

| Rritja e Kapaciteteve Njerëzore dhe Institucionale në Fushën e Sektorit Minerar |   |   |                         |   |  |   |
|---|---|---|-------------------------|---|--|---|
| Nr.   | Projekti/Aktiviteti i paraparë në vitin 2012  | Treguesi (SM)   | Institucioni përgjegjës | Kostoja në € për vitin 2012 dhe Burimi i Financimit | Rezultatet e arritura  | Komentet  |
| <b>Objektivi 1. Zhvillimi Institucional dhe i Kapaciteteve Njerëzore</b>        |   |   |                         |   |  |   |
| 1   | Trajnimi i stafit në softuerin Auto Cad Civil 3D.   | Sht. II,<br>Objektivi 1.  | KPMM                    | 10,000<br>BK  | Është bërë trajnimi i stafit ne përdorimin e programit Auto Cad Civil 3D.<br><div style="text-align: center; background-color: #6aa84f; color: white; padding: 2px;">Realizimi: 100%</div> |   |
| 2   | Realizimi i studimit mbi mundësit e futjes së institutit INKOS si institucion në kuadër të IGJK | Sht. II,<br>Objektivi 1,<br>Masa II.2.2<br>II.2.3<br>II.2.4<br>II.2.5 | INKOS sh.a              | Nuk ka kosto  | Realizimi i studimit është në fazën përfundimtare.<br><div style="text-align: center; background-color: #6aa84f; color: white; padding: 2px;">Realizimi: 80%</div>                         | Janë duke u zhvilluar bisedimet dhe angazhimet për realizimin e këtij plani |

|   |  |  |       |               |   |   |
|---|--|--|-------|---------------|---|---|
|   |  | II.2.6 dhe<br>II.2.7   |       |               |   |   |
| <b>Objektivi 2. Hulumentimi i Resurseve Minerale dhe Raportimi i Tyre</b> |  |  |       |               |   |   |
| 1   | Krijimi i arkivit elektronikë IGJK-së                      | Sht. II,<br>Objektivi 2.   | MZHE  | -             | Ka vazhduar plotësimi i arkivit të IGJK-së me të dhëna gjeologjike.<br><b>Realizimi: 100%</b>       | Ky Aktivitet vazhdon edhe ne vitet ne vijim                           |
| 2   | Plani i Menaxhimit të Resurseve Minerale të Kosovës        | Sht. II,<br>Objektivi 2.<br>Masa II.1.6  | KPMM, | 200,000<br>BK | <b>Realizimi: 0%</b>  | Projekti nuk u realizua për shkak të ri-destinim i mjeteve financiare |
| 3   | Plani vjetor i Menaxhimit të Resurseve Minerale të Kosovës | Sht. II,<br>Objektivi 2,<br>Masa II.1.6<br>Ligji Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, neni 74. | KPMM  | Nuk ka kosto  | <b>Realizimi: 0%</b>  |   |
| 4   | Përpilimi i dy plansheteve 1:25000 K34-54Bb dhe K34-54Bd.  | Sht. II,<br>Objektivi 2.   | KPMM  | 80,000<br>BK  | Informacionet gjeologjike të fituara nga hartografimi ne shkallen 1:25000<br><b>Realizimi: 100%</b> |   |

|   |  |                                   |                            |   |   |  |
|---|--|-----------------------------------|----------------------------|---|---|--|
| 5 | Elaborati i Rezervave Gjeologjike të Boksiteve në Vendburimin nr. 39 Dresnik-Dollc | Sht. II, Objektivi 2, Masa II.1.1 | Boksitet e Kosovës<br>KPMM | - | Përpilimi e Elaboratit Gjeologjikë të Rezervave<br><b>Realizimi: 100%</b> |  |
|---|--|-----------------------------------|----------------------------|---|---|--|



## SHTYLLA E TRETË

| Çështjet Sociale dhe Përfitimet e Komunitetit                        |  |  |                         |   |   |  |
|--|--|--|-------------------------|---|---|--|
| Nr.  | Projekti/Aktiviteti i paraparë në vitin 2012                             | Treguesi (SM)                              | Institucioni përgjegjës | Kostoja në € për vitin 2012 dhe Burimi i Financimit | Rezultatet e arritura   | Komentet   |
| <b>Objektivi 1. Trajtimi i Çështjeve Sociale dhe Siguria në Punë</b> |  |  |                         |   |   |  |
| 1  | Përkrahja e skemave sociale (pensioneve) të Kompleksit industrial Trepça | Sht. III,<br>Objektivi 1,<br>Masa III.1.1. | MZHE                    | 3,082,870<br>BK                                     | Janë realizuar të gjitha fondet e parapara për mbështetjen e skemave sociale të kompleksit mineralar Trepça<br><div style="background-color: #d9ead3; padding: 2px; display: inline-block;">Realizimi: 100%</div> |  |
| <b>Objektivi 2. Pjesëmarrja dhe Përfitimi i Komuniteteve</b>         |  |  |                         |   |   |  |
| 1  |  |  |                         |   |   | Nuk është paraparë asnjë projekt/aktivitet në PZSM 2012-2014 |

## SHTYLLA E KATËRT

| Përkujdesja për Mjedisin                                      |  |                                   |                         |   |   |                              |
|---|--|-----------------------------------|-------------------------|---|---|------------------------------|
| Nr.   | Projekti/Aktiviteti i paraparë në vitin 2012                     | Treguesi (SM)                     | Institucioni përgjegjës | Kostoja në € për vitin 2012 dhe Burimi i Financimit | Rezultatet e arritura   | Komentet                     |
| <b>Objektivi 1. Zgjidhja e Problemeve Mjedisore Historike</b> |  |                                   |                         |   |   |                              |
| 1   | Rehabilitimi i zonave të degraduara të Lumit Drini i Bardhë      | Sht. IV, Objektiv 1, Masa VI.1.4. | MMPH                    | 3,000,000 (70% donator dhe 30 % BK )                | Nuk ka rezultate.<br>Realizimi i projektit nuk ka filluar.<br><span style="background-color: #d9ead3; padding: 2px;">Realizimi: 0%</span> | Mungesë e mjeteve financiare |
| 2   | Rehabilitimin i zonave të shfrytëzuara (guroreve). Te braktisura | Sht. IV, Objektiv 1, Masa VI.1.4. | MMPH                    | 500,000 (70% donator dhe 30 % BK )                  | Nuk ka rezultate.<br>Realizimi i projektit nuk ka filluar.<br><span style="background-color: #d9ead3; padding: 2px;">Realizimi: 0%</span> | Mungesë e mjeteve financiare |
| 3   | Rehabilitimi i zonave të shfrytëzuara minerare (historike).      | Sht. IV, Objektiv 1, Masa VI.1.4. | MMPH                    | 1,000,000 (70% donatorët 10% BK, 20% Trepça)        | Nuk ka rezultate.<br>Realizimi i projektit nuk ka filluar.<br><span style="background-color: #d9ead3; padding: 2px;">Realizimi: 0%</span> | Mungesë e mjeteve financiare |
| 4   | Trajtim i ujerave të   | Sht. IV,                          | MMPH                    | 200,000   | Nuk ka rezultate.   | Mungesë e mjeteve            |

|   |   |   |        |   |  |  |
|---|---|---|--------|---|--|--|
|   | Minierave acide   | Objektivi 1, Masa VI.1.4.   |        | (70% donator dhe 30 % BK)                               | Realizimi i projektit nuk ka filluar.<br>Realizimi: 0% | financiare   |
| 5 | Rehabilitimi i parkut industrial në Mitrovice               | Sht. IV, Objektivi 1, Masa IV.1.1., IV.1.2., IV.1.3., VI.1.4. dhe VI.1.5. | Trepça | 500,000 (Donator, Trepça-AKP Komuna e Mitrovicës, MMPH) | Nuk ka rezultate.<br>Realizimi: 0%                     | Është mbajtur konferenca e donatoreve dhe është bërë dizajni i projektit në të cilin është kyçur edhe rehabilitimi i pjesës që përfshinë pjesën veriore. Deri më tani mjetet janë siguruar vetëm nga Trepça dhe MMPH |
| 6 | Trajtimi i ujërave acidike në Minierën e Artanës.           | Sht. IV, Objektivi 1, Masa IV.1.1., IV.1.2., IV.1.3., VI.1.4. dhe VI.1.5. | Trepça | 100,000 (Donator, Trepça-AKP, MMPH)                     | Nuk ka rezultate.<br>Realizimi:0%                      | Mungesa e Mjeteve Financiare   |
| 7 | Faza e dytë e Rehabilitimit/mbulimit i deponis së Kelmendit | Sht. IV, Objektivi 1, Masa IV.1.1.,                                       | Trepça | 100,000 Donator   | Nuk ka rezultate.<br>Realizimi: 0%                     | Mungesa e Mjeteve Financiare   |

|  |   |  |            |            |   |   |
|--|---|--|------------|------------|---|---|
|  |   | IV.1.2.,<br>IV.1.3.,<br>VI.1.4. dhe<br>VI.1.5. |            |            |   |   |
| 8  | Hartimi i projektit të ri-kultivimit të palosjeve të brendshme të jashtme dhe deponive të hirit në M.S Kosova | Sht. IV, Objektiv 1, Masa VI.1.4.              | KEK        | 22,000 KEK | Nuk ka rezultate.<br>Realizimi: 0%  | Mungesa e Mjeteve Financiare  |
| 9  | Hulumtimet gjeomekanike të deponis/ palosjes në Bardh   | Sht. IV, Objektiv 1.                           | INKOS sh.a | 44,000 KEK | Nuk ka rezultate.<br>Realizimi: 0%  | Ky projekt është shtyrë për me vonë, pritet të realizohet në Qershor të vitit 2013. |
| <b>Objektivi 2. Mbrojtja e Mjedisit nga Aktivitet Minerare</b> |   |  |            |            |   |   |
| 1  | Monitorimi i Mjedisit DPQ   | Sht. VI, Objektiv 2.                           | INKOS sh.a | 50,000 KEK | Janë monitoruar ujërat, toka dhe ajri në zonat e KEK-ut, si dhe janë identifikuar ndotësit kryesor në atë zonë, me qëllim të parandalimit të ndotjes së mjedisit në këto zona.<br>Realizimi: 100% |   |
| 2  | Monitorimi i mjedisit DGJ (TC Kosova A dhe TC Kosova B)   | Sht. VI, Objektiv 2.                           | INKOS sh.a | 70,000 KEK | Është bërë monitorimi i mjedisit lidhur me imisionin dhe emisionin në TC Kosova A dhe TC Kosova B<br>Realizimi: 100%  |   |

## PROJEKTET RELEVANTE<sup>1</sup>

| <b>Projektet Tjera Relevante për Sektorin e Minerar</b> |  |               |                         |   |   |  |
|---|--|---------------|-------------------------|---|---|--|
| Nr.   | Projekti/Aktiviteti i paraparë në vitin 2012 | Treguesi (SM) | Institucioni përgjegjës | Kostoja në € për vitin 2012 dhe Burimi i Financimit | Rezultatet e arritura   | Komentet                                   |
| 1   | Mikrozonimi Sizmik i Gjilanit                | -             | MZHE                    | 104,626<br>BK                                       | <p>Është realizuar studimi i mikrozonimit sizmik për 60 hektarë sipërfaqe në komunën e Gjilanit. Janë përfitur parametrat sizmik për sipërfaqen e cekur. Është krijuar harta sizmike për këto parcela.</p> <div style="background-color: #d9ead3; padding: 2px; display: inline-block;">Realizimi: 100%</div> | Kostoja e përgjithshme:<br>155,000 €<br>BK |

<sup>1</sup> Janë projektet e paraqitura në PZSM 2012-2014, të cilat nuk kanë tregues të qartë në Strategjinë Minerare.

## INDIKATORËT E PËRFORMANCËS


Në tabelën si më poshtë është paraqitur përqindja e realizueshmërisë së PZSM për vitin 2012.

| Projektet/Aktivitet të paraqitura sipas PZSM-së  | Numri i Projekteve /aktiviteteve | Realizimi në Përqindje |
|--|----------------------------------|------------------------|
| <b>Shtylla e parë (I)</b><br><b>(Krijimi i Kushteve të Favorshme për Valorizimin Ekonomik të Resurseve Minerale dhe Tërheqjen e Investimeve)</b> | <b>19</b>                        | <b>73%</b>             |
| <b>Shtylla e dytë (II)</b><br><b>(Rritja e Kapaciteteve Njerëzore dhe Institucionale në Fushën e Sektorit Minerar)</b>                           | <b>7</b>                         | <b>69%</b>             |
| <b>Shtylla e tretë (III)</b><br><b>(Çështjet Sociale dhe Përfitimet e Komunitetit)</b>   | <b>1</b>                         | <b>100%</b>            |
| <b>Shtylla e katërt (IV)</b><br><b>(Përkujdesja për Mjedisin)</b>  | <b>11</b>                        | <b>18%</b>             |
| <b>Projektet Relevante</b>   | <b>1</b>                         | <b>100%</b>            |
| <b>Realizimi total i projekteve/aktiviteteve të PZSM-së për vitin 2012</b>   | <b>39</b>                        | <b>69.07%</b>          |

**Shënim:** KEK-u ka realizuar 4 projekte (riparimin dhe blerjen e pajimeve për eksploatim të qymyrit; shih shtylla I, Objektivi 2, projektet: 10, 11, 12 dhe 13) të cilat nuk kanë qenë të paraqitura në dokumentin e PZSM-së 2012-2014. Megjithatë, projektet janë në harmoni me masat dhe politikat zhvillimore të parapara me SM, përkatësisht me Objektivën 2 të shtyllës I të SM-së.

Pasi që katër projektet e raportuara nga KEK, janë realizuar 100%, përfshirja e tyre në totalin e realizimit të projekteve/aktiviteteve të PZSM-së për vitin 2012, e jep indikatorin real të realizimit të PZSM-së për vitin 2012 në nivelin prej **69.07%**.

Grafiku - Indikatori i performancës, në përqindje (%) në bazë të realizimit të projekteve/aktiviteteve sipas institucionit\*\* :



\*\*Përformanca e KEK-ut për vitin 2012 përfshinë edhe 4 projektet të cilat nuk i ka paraqitur në PZSM, por që i ka realizuar brenda vitit 2012 (shih shtylla I, Objektiv 2, projektet 10, 11, 12 dhe 13).

\*\* Përformanca e KPMM-së është paraqitur së bashku me përformacën e kompanive - Newco Ferronikel Complex, L.L.C, Sharrem sh.p.k, Arsi sh.p.k, Boksitet e Kosovës.

